



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PER MBESHITETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА




Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

# PUNA E PARLAMENTIT DHE ÇAKTIMI I RENDIT TË DITËS NË PARLAMENTET E SHTETEVE TË NDRYSHME

AUTORË: ŠTĚPÁN PECHÁČEK DHE MARTIN KUTA

SHKURT 2022



Implementuar nga:





*Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Nacional Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.*



# PËRMBAJTJA

<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>5</b>
<b>II.</b>	<b>TRANSPARENCA NË PUNËN E PARLAMENTEVE - PASQYRA TEORIKE DHE KOMPARATIVE</b>	<b>7</b>
	Miratimi i ligjeve në parlamente	7
	Organizimi i punimeve të parlamentit	8
	Përcaktimi i rendit të ditës	9
	Regullimi i diskutimeve parlamentare	10
	Veglat e TI-së për transparencën parlamentare – kalendari i parlamentit	11
	Kalendari i parlamentit (orari i punës së parlamentit) – përkufizim	12
<b>III.</b>	<b>GJETJET PRELIMINARE</b>	<b>13</b>
<b>IV.</b>	<b>SI JANË TË RREGULLUARA PUNIMET E PARLAMENTIT NË SHETETET E ZGJEDHURA</b>	<b>17</b>
	Çekia	18
	Estonia	23
	Gjermania	30
	Republika e Maqedonisë së Veriut	34
	Sllovakia	38
	Suedia	43
<b>V.</b>	<b>REKOMANDIMET</b>	<b>48</b>
	<b>REFERENCAT</b>	<b>49</b>

## **IMPRESUM**

**Titulli:** Puna e parlamentit dhe caktimi i rendit të ditës në parlamentet e shteteve të ndryshme

**Botues:** Instituti Nacional Demokratik

**Autorë:** Štěpán Pecháček dhe Martin Kuta

**Dizajni:** Dejan Kuzmanovski

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Parlamentet janë institucione në të cilat njëkohësisht kryhen më shumë detyra dhe bëhet debat politik lidhur me çështje të ndryshme, (mes tjerash):

- Debat i përgjithshëm politik dhe përfaqësim i mendimeve të qytetarëve;
- Mbikëqyrje mbi veprimet qeveritare dhe;
- Formulim të prioriteteve për politikën publike përmes diskutimit dhe miratimit të propozim-ligjeve.

Koha në dispozicion është e shkurtër, ndërsa punimet e parlamentit medoemos duhet të rregullohen me qëllim që të racionalizohet diskutimi mbi pikat në organin ligjvënës.

Mënyra sipas së cilës rregullohen punimet e parlamentit vështrohet nga dy aspekte:

- Korniza e qartë dhe fikse e punës së parlamentit (orari) që parasheh afatet kohore për diskutim lidhur me propozim-ligjet në nivele të ndryshme (plenare dhe komisione; lexime legjislativë dhe diskutime në komisione);
- Rregulla se si të vendoset një pikë për diskutim (d.m.th. përcaktimi i rendit të ditës).

Parlamentet e përfshira në këtë dokument kanë kornizë fikse të punës parlamentare, përkatësisht posedojnë kalendar periodik të javëve/ditëve të cilat u dedikohen detyrave konkrete. Kjo mundëson një parashikueshmëri të nivelit të lartë të punës së parlamentit dhe të diskutimit, si dhe të rezultatit final për deputetët, qeverinë, dhe shoqërinë në përgjithësi. Kalendar i parlamentit, si një vegël e TI-së, përdoret me qëllim që shfrytëzuesit jashtë parlamentit të njoftohen me agjendën e punës së tij.

Ky dokument vështron aspektet institucionale të caktimit të punimeve të parlamentit që do të thotë se janë analizuar rregullat që formësojnë sjelljen e deputetëve. Dokumenti është bazuar në një studim të rregulloreve dhe ueb-faqeve përkatëse që kanë të bëjnë me përcaktimin e rendit të ditës dhe kornizën e punës së parlamentit.

Në këtë dokument janë përfshirë parlamentet e Çekisë (*Poslanecká sněmovna*), Estonisë (*Riigikogu*), Gjermanisë (*Bundestag*), Sllovakisë (*Národná rada*), Sllovenisë (*Državni sabor*), Suedisë (*Riksdag*), dhe Republika e Maqedonisë së Veriut (*Sobranie*). Këto shtete të Evropës qendrore dhe lindore kryesisht kanë sistem parlamentar njëdhomësh dhe me madhësi përafërsisht të njëjtë të shtetit. Gjermania është paraqitur si parlament i shteteve të Evropës perëndimore.





---

## **II. TRANSPARENCA NË PUNËN E PARLAMENTEVE – PASQYRA TEORIKE DHE KOMPARATIVE**

### **MIRATIMI I LIGJEVE NË PARLAMENTE**

Parlamenti është organi më i lartë ligjvënës, i cili jo domosdoshmërisht ka pushtet ekzekutiv, por përfaqëson qytetarët dhe i miraton ligjet përmes të cilave qeveria, si organ më i lartë ekzekutiv, i zbaton programet e veta politike (d.m.th. përgatitjen e ligjeve ose më konkretisht hartimin e tyre). Sistemi parlamentar i pushtetit karakterizohet me mëvetësi institucionale, por me lidhshmëri funksionale. Lidhshmëria në aspektin funksional nënkupton atë që qeveria është institucion më vete, por që pushtetin e saj e merr nga shumica e deputetëve në parlament.

Përgatitja e ligjeve nënkupton diskutim publik lidhur me alternativat për politikën të cilat duhet të formojnë thelbin e politikave publike, e pastaj vendosjen e tyre në ligj, përkatësisht hartimin e një versioni detyrues në formë propozim-ligji dhe miratimin e tij në ligj. Në këtë drejtim, diskutimi dhe miratimi i një ligji të ri duhet të organizohet në mënyrën më të parashikueshme, duke i siguruar qasje publikut. Procesi i miratimit të një ligji të ri, gjithashtu, nuk duhet të krijojë pasiguri dhe kaos. Prandaj, një nga pyetjet më thelbësore gjatë miratimit të ligjeve është si dhe kur miratohet ligji në parlament. Kjo gjithashtu është pyetje thelbësore që e prek edhe publikun e gjerë..

## ORGANIZIMI I PUNIMEVE TË PARLAMENTIT

Parlamenti nuk e ka të domosdoshme t'i rrisë kapacitetet e brendshme që të mund t'i organizojë punimet e veta. Në këtë drejtim, pjesa dërmuese e parlamenteve zbatojnë një **qasje të rregulluar në organizimin e punimeve të tyre të brendshme** (punimet e parlamentit). Me nocionin të *rregulluar* do të thotë që dispozitat për organizimin e punimeve të parlamentit janë paraparë në një dokument të brendshëm juridiko-normativ në të cilin përcaktohet organizimi i brendshëm i parlamentit (siç është Rregullorja e punës). Dispozitat përkatëse që rregullojnë punimet e parlamentit në mënyrë implicite pasqyrojnë procesin ligjvënës (numrin e leximeve plenare të propozim-ligjit, periudhat ndërmjet leximeve të ndryshme, referimet në komisionet e ndryshme parlamentare, etj.). Organizimi i tillë zakonisht përfshin korniza të caktuara kohore (qofshin ato javë ose ditë brenda javës) për aktivitetet e ndryshme parlamentare në nivele të ndryshme – p.sh. seanca parlamentare (lexime të ndryshme), dhe mbledhje të komisioneve.

Ky organizim i punës, i rregulluar në këtë mënyrë, u është bërë i njohur paraprakisht deputetëve, qeverisë, dhe opinionit të gjerë. Kështu, ai mundëson rezultate të parashikueshme të punimeve parlamentare për një periudhë të dhënë kohore. Gjithashtu, është më e lehtë të parashikohet se kur formalisht do të fillojë procedura legjislative dhe cili është afati i mundshëm brenda të cilit përfundohet procedura legjislative.

Koha në dispozicion është e shkurtër madje edhe për procesin e përgatitjes së ligjit. Prandaj, është e rëndësishme të përcaktohet rendi i ditës, e kjo nënkupton procesin e përcaktimit të diskutimit dhe votimit për alternativat e politikave. Kur ekziston një rregull i saktë dhe mirë i strukturuar se si të përcaktohet rendi i ditës, ai parandalon krijimin e kaosit dhe gjërave të paparashikueshme në procesin e miratimit të ligjit. Rregullat e **përcaktimit të rendit të ditës** janë ndër rregullat më të rëndësishme që u mundësojnë parlamenteve miratimin e ligjeve. Falë këtyre rregullave, parlamentet mund t'ia dalin mbanë me situata të pakontrolluara dhe ta strukturojnë diskutimin e vet, nga aspekti i rregullit të shumicës, d.m.th. vendosjen e pikave në rend dite, për të cilat ekziston mbështetja më e madhe dhe rezervat më të vogla.

Veç tjerash, ekzistojnë dy arsye për një rend dite të parashikueshëm dhe të disponueshëm për publikun që ka të bëjë me diskutimin parlamentar. Së pari, me një vendosje të tillë, partive politike dhe grupeve të tyre parlamentare do t'u mundësojë të përqendrohen në votimin për çështje shumë të rëndësishme. Së dyti, kjo mundëson që të mobilizohet mbështetja nga opinioni i gjerë publik në një datë dhe kohë konkrete. E gjithë kjo kontribuon kështu për një legjitimitet më të lartë publik të ligjeve para popullit. Sa më shumë ligje të miratohen në mënyrë transparente, të parashikueshme, të disponueshme për qytetarët, aq më shumë legjitimitet kanë ato. Që këtu buron edhe iniciativa e fuqishme në parlament për të miratuar procedura të sakta në përcaktimin e rendit të ditës, në aspekt të agjendës për miratimin e ligjeve.

Organizimi i brendshëm i punës së parlamentit në kuadër të mandatit të përbërjes parlamentare, apo thënë më shkurt gjatë një legjislature gjithashtu ndikon në procesin e përcaktimit të rendit të ditës, e me këtë edhe në kalendarin i cili e tregon orarin e punës së parlamentit.

Mandati parlamentar apo legjislatura ndahet në një sesion të vetëm (punime të përhershme) apo në më shumë sesione (sesion vjetor ose vjeshtor dhe pranveror), që zakonisht përbëhen nga një numër i caktuar mbledhjesh. Punimet e përhershme mund të ndërpriten për një periudhë të caktuar kohore, dhe zakonisht kjo bëhet gjatë pushimit veror. Mbledhje nënkupton mbajtje të seancave të parlamentit. Ndërprerje e mbledhjeve të parlamentit është periudha ndërmjet përfundimit të një seance dhe fillimit të seancës së ardhshme. Pushimi veror të parlamentet me punime të përhershme gjithashtu quhet ndërprerje e seancave parlamentare, edhe pse kjo ka një kuptim tjetër.

Në Çeki, Gjermani, Maqedoni të Veriut dhe Sllovaki parlamenti është në punime të përhershme, që nënkupton se parlamenti është në punime gjatë gjithë legjislaturës. Estonia dhe Sllovenia përdorin sistemin e sesionit vjeshtor dhe pranveror. Në Suedi, seancat parlamentare zgjasin për një vjet.

Sistemi i seancave parlamentare ndikon edhe në procesin ligjvënës, përkatësisht në kontinuitetin dhe diskontinuitetin e procesit legjislativ të/ndërmjet seancave dhe organizimin e rendit të ditës në një afat më të gjatë, duke përfshirë edhe strukturën e kalendarit parlamentar. Kjo mund të shihet kryesisht në rastin e Suedisë në të cilin, nën rrethana specifike, një pikë e rendit të ditës mund të bartet në seancën e radhës.

## **PËRCAKTIMI I RENDIT TË DITËS**

Përcaktimi i rendit të ditës, përkatësisht radhitja e pikave për diskutim, si dhe miratimi i radhës për diskutim sipas pikave, është me rëndësi thelbësore për organizimin pa pengesa të punës së parlamentit. Me këtë rast, mund të elaborohen këto tema:

- Kush mund t'i propozojë temat dhe radhitjen e temave (koha për diskutim)?
- Kush mund ta ndryshojë radhën apo kohën e caktuar për diskutim në temën e dhënë?
- A mundësojnë rregullat me të cilat është përcaktuar diskutimi, të planifikohet koha e saktë për diskutimin e temës së caktuar dhe votimin për temë të caktuar?

## RREGULLIMI I DISKUTIMEVE PARLAMENTARE

Diskutimi për tema në parlament përbëhet kryesisht prej dy pjesësh themelore: diskutimi dhe votimi. Në teori ekzistojnë katër lloje të rregullimit të diskutimit:

- 1) Diskutim i lirë parlamentar, në të cilin, në parim, nuk është e kufizuar koha e fjalës, ndërsa Rregullorja jep mundësinë, në bazë të vendimit të shumicës parlamentare, të ndërpritet ose kufizohet debati në raste të arsyeshme. Kjo e drejtë mund të jetë implicite, përkatësisht debati mund të ndërpritet nga Kryetari nëse nuk ka kundërshtime ndaj një procedure të tillë, gjë që konfirmohet me votim në seancën plenare. Rastet e tilla përfshijnë p.sh. Estoninë dhe Republikën Çeke.
- 2) Diskutim parlamentar i rregulluar pjesërisht, në të cilin e drejta për të kufizuar kohën e debatit dhe ndarjen e tij e ka organi kolektiv i parlamentit (Këshilli, Konferenca e Kryetarëve etj.). Shembujt e këtillë përfshijnë parlamentin e Finlandës dhe Kuvendin Nacional Francez.
- 3) Diskutim parlamentar i rregulluar pjesërisht në të cilin me Rregullore Kryetarit të Kuvendit i jepet e drejtë diskrecionale ta rregullojë kohën e fjalimit mbi bazën ad hoc. Kuvendi Nacional Bullgar dhe Dhoma e Ulët e Parlamentit Britanik janë shembuj të modifikimeve të tilla.
- 4) Diskutim parlamentar i rregulluar në mënyrë rigoroze, ku në Rregullore përcaktohet koha standarde e fjalës nga deputetët e grupeve të ndryshme parlamentare. Kështu është për shembull, në Dhomën e Ulët të Parlamentit Belg, në Parlamentin e Danimarkës, *Bundestagun* Gjerman ose në Këshillin Nacional Austriak.

Për sa i përket votimit, mund të identifikojmë dy modele themelore sipas të cilave organizohet votimi. I pari ka të bëjë me votimin menjëherë pasi të ketë përfunduar diskutimi. Modeli i dytë ka të bëjë me votimin në një moment të caktuar. Sipas këtij modeli diskutimi dhe votimi zhvillohen ndaras.

## VEGLAT E TI-SË PËR TRANSPARENCËN PARLAMENTARE – KALENDARI I PARLAMENTIT

Fillimi i funksionimit të ueb-faqes së parlamentit ka vendosur një mënyrë shumë demokratike dhe transparente për t'ia komunikuar opinionit të gjerë punën e parlamentit. Nëpërmjet ueb-faqeve të parlamentit të gjitha pikat e vendosura për diskutim në parlament bëhen të disponueshme për publikun, duke mbështetur kështu rolin përfaqësues të parlamenteve. Faqet e internetit i mundësojnë parlamentit që t'i informojë qytetarët në mënyrë të qartë, në kohë dhe në mënyrë efikase.

Para se të fillojnë të hapen në mënyrë masovike ueb-faqet, informimin e qytetarëve për punën e parlamentit kryesisht e bënin partitë politike dhe mediat me një nivel të lartë të ekskluzivitetit në aspekt të temave të prezantuara. Partitë kanë informuar kryesisht për temat relevante për programet e tyre apo pozitat e caktuara politike. Mënyra e informimit është varur gjithashtu nga fakti nëse ato ishin parti në pushtet ose parti opozitare. Mediat informonin për temat të vlefshme për t'u publikuar. Kështu, informatat nuk ishin gjithëpërfshirëse, por vetëm të pjesshme dhe subjektive.

Sipas **Unionit ndërparlamentar**, në vitin 2008, 59% e të gjithë parlamenteve në botë kanë përdorur faqet e internetit me qëllim që të prezantojnë kalendarin parlamentar për seancat plenare.<sup>1</sup> Në 2018, 75% të parlamenteve publikonin kalendarin parlamentar dhe 70% të komisioneve paraqisnin kalendarët e komisioneve ose një rend dite të seancave të komisioneve.<sup>2</sup>

45% e parlamenteve e paraqesin rendin e ditës të seancave plenare të paktën dy javë më parë, 24% e parlamenteve e paraqesin rendin e ditës të seancave plenare 2 ditë apo të paktën ditën e njëjtë para seancës plenare. Shifrat janë pothuajse të njëjta në rastin e rendit të ditës të mbledhjeve të komisioneve.<sup>3</sup>

Sipas hulumtimit të IPU-së, parlamentet e përfshira përdorin mjetet vijuese të TI-së për të bërë informacionet të disponueshme për qytetarët përmes internetit (shihni Figurën 1).

1 WILLIAMSON, Andy, Andy RICHARDSON a Avinash BIKHA. *Raporti botëror për e-Parlament 2018*.

2 WILLIAMSON, Andy, Andy RICHARDSON a Avinash BIKHA. *Raporti botëror për e-Parlament 2018*.

3 WILLIAMSON, Andy, Andy RICHARDSON a Avinash BIKHA. *Raporti botëror për e-Parlament*, s. 62.

**Figura 1. Veglat e TI-së për informimin e qytetarëve**

	2018	2016	2008 <sup>35</sup>
<b>Funksionet e seancës plenare</b>			
Procesverbalët e seancave plenare	84%	79%	70%
Kalendarët dhe oraret e seancave plenare	75%	78%	59%
Fjalimet dhe bazat e të dhënave të seancës plenare	75%	78%	70%
Baza e të dhënave e ligjeve të miratuara nga parlamenti	69%	74%	
Votimi në seancë plenare	69%	67%	65%
Statusi/ndjekja e projektligjit	65%	64%	
Pyetjet për qeverinë	58%	50%	52%
Statusi/ndjekja e amendamenteve	55%	55%	64%
Hartimi i amendamenteve	46%	45%	
Hartimi i projektligjeve	44%	42%	
Dokumentet tjera për shqyrtim	34%	31%	11%
Analiza e buxhetit të propozuar nga qeveria	32%	22%	
<b>Funksionet e komisioneve</b>			
Raportet e komisioneve	71%	72%	64%
Kalendarët dhe oraret e komisioneve	70%	70%	
Procesverbalët e takimeve të komisioneve	67%	68%	63%
Faqet e internetit të komisioneve	55%	52%	
Votimi në komisione	30%		
<b>Funksionet administrative dhe mbështetëse</b>			
Menaxhimi dhe mbështetja e faqes të internetit të parlamentit	90%	91%	84%
Sistemi i BNj	78%	77%	70%
Sistemi i menaxhimit financiar	78%	76%	
Menaxhimi i resurseve të bibliotekës	71%	59%	
Arkiva digjitale e dokumenteve të parlamentit	71%	68%	
Katalogu i bibliotekës elektronike (onlajn)	65%	57%	
Sistemi për komunikim me konstituentët	63%	56%	36%
Zbulimi financiar	36%	38%	
Menaxhimi dhe mbështetja për faqet e internetit të deputetëve	19%	21%	34%
<b>Asnjë nga ato më sipër</b>			
Asnjë	1%		

## KALENDARI I PARLAMENTIT (ORARI I PUNËS SË PARLAMENTIT) - PËRKUFIZIM

Kalendari i parlamentit është program javor apo i aktiviteteve javore të parlamentit, i cili më për së afërmi e përcakton agjendën konkrete të parlamentit për një ditë ose javë konkrete.

Me kalendar nënkuptojmë:

- Planin teknik kohor për organizimin e seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve.
- Radhën e pikave të rendit të ditës për seancat plenare.
- Radhën e pikave të rendit të ditës për mbledhjet e komisioneve.

## III. GJETJET PRELIMINARE

Shtëpitë ligjvënese e rregullojnë punën e tyre parlamentare me një kornizë precize, në të cilën zhvillohen diskutime politike dhe teknike për propozim-ligjet. Kjo kornizë pasqyron procesin ligjvënës (numrin e leximeve plenare, diskutimet në seanca plenare/komisione dhe cila prej tyre zhvillohet e para, kalimin në komisione për diskutim plotësues). Korniza e tillë, qoftë në bazë javore ose mujore, përcakton periudhën kohore për diskutim të propozim-ligjeve në seanca plenare, kur ato i dërgohen komisioneve, dhe kur të njëjtat definitivisht do të miratohen nga parlamenti. Rrjedhimisht, korniza përbëhet prej pjesëve saktësisht të caktuara të punës së parlamentit:

- Seancës plenare (për leximet plenare të propozim-ligjeve);
- Mbledhjes së komisionit (për shqyrtim të detajuar të propozim-ligjeve në një sektor të caktuar);
- Seancës plenare (në të cilën duhet të ndodh miratimi përfundimtar).

Kjo kornizë është saktë e definuar për çdo seancë, duke mundësuar kështu organizimin e parashikueshëm të punës së parlamentit. Në disa raste, korniza gjithashtu jep udhëzime të qarta për atë se kur mund të iniciohet diskutimi për një propozim-ligj (d.m.th. të vihet në diskutim).

Rregullorja ose normat tjera ligjore në parlamentet përkatëse nuk e rregullojnë në mënyrë konkrete ekzistencën e kalendarit. Ekzistenca e kalendarit vjen nga praktika e përgjithshme e planifikimit të punës së parlamentit dhe organeve të tij dhe parimit të transparencës së aktiviteteve parlamentare, prandaj rendi i ditës medoemos duhet të jetë i disponueshëm për opinionin e gjerë dhe aktorët tjerë.

Publikimi i rendit të ditës të seancave plenare, të mbledhjeve të komisioneve, dhe organeve tjera të parlamentit bazohet në dispozitat e përgjithshme të Rregullores me të cilat parashihet transparenca e seancave për publikun.

Me rend të ditës nënkuptojmë të gjitha nënpikat, përkatësisht të gjitha propozim-ligjet, raportet e komisioneve, raportet e qeverisë dhe dokumentet tjera të cilat mund të shqyrtohen në seancë plenare ose në mbledhjet e komisionit.

Publikimi i rendit të ditës është parakusht kryesor për të siguruar transparencë të diskutimeve parlamentare për publikun, grupet e interesit dhe palët tjera të përfshira.

Takimet e grupeve të deputetëve nuk janë të përfshira në kalendar ose në agjendë, sepse grupet e deputetëve nuk janë organe politike të parlamentit por të partive.

Vendimin për kalendarin dhe rendin e detajuar të ditës të seancës plenare në kuadër të parlamenteve që ishin objekt i kësaj analize, e miraton organi vetadministrues i kuvendit, pa intervenimin e qeverisë. Rendin e detajuar të ditës për mbledhjet e komisioneve e miraton vetë komisioni.

Vendimi i organit vetadministrues merret me konsensus. Konsensusi ka kuptim procedural, jo material. Kjo do të thotë që partitë e opozitës nuk vendosin veto ose nuk i prolongojnë propozim-ligjet e qeverisë, por kërkojnë të kenë një mundësi të drejtë për t'i kritikuar ato.

Rendi i ditës i miratuar nga organi vetadministrues miratohet ose nga parlamenti (miratim pozitiv) ose konsiderohet i miratuar, pa diskutim të mëtutjeshëm plenar (miratim negativ).

Krahasimi i aspekteve relevante të kalendarëve të parlamenteve (oraret e diskutimit dhe votimi i pikave), diskutimi parlamentar (rregullimi i diskutimit parlamentar, mënyra e votimit) dhe përcaktimi i rendit të ditës është paraqitur në tabelat 1-5.

**Tabela 1. Struktura dhe disponueshmëria e kalendarit**

Shteti	Rregullativa ligjore ose rregullativa të tjera	Orari/rendi i ditës i miratuar nga	Periudha e mbuluar	Forma e disponueshmërisë për qytetarët
Çekia	Nuk ka rregullativa, bazohet në praktikë	Organi vetadministrues (Komiteti Drejtues)	Gjysmë vjetore	Ueb-faqe
Estonia	Nuk ka rregullativë, bazohet në praktikë	Organi vetadministrues (Këshilli i Riigikogu)	Periudhë vjetore	Ueb-faqe
Gjermania	Nuk ka rregullativë, bazohet në praktikë	Organi vetadministrues (Këshilli i Pleqve)	Gjysma e vitit, kalendar i detajuar për javën e ardhshme	Ueb-faqe
Republika e Maqedonisë së Veriut	Nuk ka rregullativë	Seanca plenare (Kuvendi)	Periudhë <i>ad hoc</i> (një muaj)	Ueb-faqe
Slovakia	Nuk ka rregullativë, bazohet në praktikë	Organi vetadministrues ( <i>Gremium</i> )	Periudhë vjetore	Ueb-faqe
Suedia	Nuk ka rregullativë, bazohet në praktikë	Organi vetadministrues (Këshilli i Riksdag)	Periudhë <i>ad hoc</i>	Ueb-faqe



Tabela 2. Përmbajtja e kalendarit

Shteti	Mbledhjet e Trupave të punës	Agjenda e Kryetarit	Vizitat ndërkombëtare	Takimet e grupeve të deputetëve	Ngjarjet e disponueshme për qytetarët
Çekia	Orari javor i seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve	Jo	Po	Jo	Pjesë e veçantë në faqen e internetit
Estonia	Orari javor i seancave të Riigikogu (plenare dhe të komisioneve)	Jo	Jo <sup>4</sup>	Jo	Nuk ka informacione konkrete
Gjermania	Orari javor i seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve. Rendi i detajuar i ditës është i disponueshëm vetëm për seancat plenare	Jo	Jo	Jo	Pjesë e veçantë në faqen e internetit
Republika e Maqedonisë së Veriut	Orari mujor	Po	Po	Jo	Po
Slovakia	Orari javor i seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve, afatet për dorëzimin e propozim-ligjeve	Jo	Jo	Jo	Pjesë e veçantë në faqen e internetit
Suedia	Orari mujor/javor i punës i Rigsdag dhe trupave të punës	Po	Jo	Jo (Debatet e liderëve të partive)	Pjesërisht po

Table 3. Procedural details of agenda approval and discussion

Shteti	Miratimi i rendit të ditës (negative/pozitive)	Amendamente të dorëzuara për rendin e ditës nga ndonjë deputet	Kufizime në dorëzimin e amendamenteve	Llojet e rregullimit të diskutimit	Përqendrimi i votave
Çekia	Pozitive	Po	Jo <sup>5</sup>	Diskutim i lirë	Jo
Estonia	Pozitive (miratohet në seancë plenare)	Jo	Jo	Është i rregulluar rreptësisht	Jo
Gjermania	Negative	Jo	Grup i deputetëve koha	Është i rregulluar rreptësisht	Jo
Republika e Maqedonisë së Veriut	Pozitive (miratohet në seancë plenare)	Po	Jo	Diskutim i lirë	Jo
Slovakia	Pozitive	Po	Jo	Është i rregulluar pjesërisht	Po, përveç votimit procedural (neni 36 i Rregullores)
Suedia	Pozitive (vetëm diskutim)			Është i rregulluar rreptësisht	Po (Nuk është paraparë me Rregullore)

4 Only in news section.

5 Only in specific sections, not as a integral part of the calendar.

**Tabela 4. Rendi i ditës i seancave plenare**

Shteti	Koha e publikimit	Përmbajtja	Si publikohet
<b>Çekia</b>	Një javë para seancës ose menjëherë pas vendimit për thirrjen e saj	Lista e pikave që lidhen me bazën e të dhënave ligjvënëse	Në faqen kryesore të internetit
<b>Estonia</b>	Një javë para seancave	Lista e pikave që do të diskutohen që lidhen me bazën e të dhënave të aktivitetit ligjvënës	Në faqen kryesore të internetit
<b>Gjermania</b>	Një javë para seancave	Lista e pikave të lidhura me bazën e të dhënave ligjvënëse dhe përshkrimi i shkurtër i temës	Në faqen kryesore të internetit
<b>Republika e Maqedonisë së Veriut</b>	Dhjetë ditë para seancës	Propozim rendi i ditës, përkatësisht lista e pikave	Në faqen kryesore të internetit
<b>Slovakia</b>	Një javë para seancës ose menjëherë pas vendimit	Lista e pikave që lidhen me bazën e të dhënave ligjvënëse	Në faqen kryesore të internetit
<b>Suedia</b>	Ngjarjet dhe aktivitetet e ardhshme sipas planit dyvjeçar	Lista e pikave të lidhura me bazën e të dhënave ligjvënëse dhe mbledhjeve të komisionit	Në faqen kryesore të internetit


**Tabela 5. Rendi i ditës i komisioneve**

Shteti	Koha e publikimit	Përmbajtja	Si publikohet
<b>Çekia</b>	Pas vendimit për propozim rendin e ditës	Lista e pikave dhe orari kohor	Në faqen e internetit të komisionit konkret
<b>Estonia</b>	Në javën vijuese	Lista e pikave që do të diskutohen	Në faqen e internetit të komisionit konkret
<b>Gjermania</b>	Në javën vijuese	Lista e pikave të lidhura me bazën e të dhënave ligjvënëse dhe përshkrimi i shkurtër i temës	Në faqen kryesore të internetit – pjesa e veçantë
<b>Republika e Maqedonisë së Veriut</b>	Ngjarjet e ardhshme në muajin vijues	Lista e pikave dhe orari kohor	Në faqen kryesore të internetit Në kalendar
<b>Slovakia</b>	Në javën vijuese	Lista e pikave dhe orari kohor	Në faqen kryesore të internetit – pjesa e veçantë
<b>Suedia</b>	Ngjarjet e ardhshme dhe aktivitetet sipas planit dyvjeçar	Lista e pikave që do të diskutohen	Në faqen kryesore të internetit në një kalendar

# IV.

**SI JANË TË RREGULLUARA  
PUNIMET E PARLAMENTIT NË  
SHTETET E ZGJEDHURA**

# ÇEKIA



Dhoma e Ulët apo siç quhet edhe Dhoma e Deputetëve është në punime të përhershme. Sipas nenit 34 të Kushtetutës së Çekisë, të dy Dhomat janë në punime të përhershme. Legjislatura zgjidhet për periudhën katërvjeçare, ndërsa punimet e përhershme të Parlamentit përkrijnë me mandatin zgjedhor.

## PËRCAKTIMI I RENDIT TË DITËSZ

Duke u bazuar në nenin 54 të Rregullores, Dhoma e Ulët e përcakton rendin e ditës dhe mënyrën e shqyrtimit të pikave të caktuara me kërkesë të Kryetarit të Dhomës së Ulët. Nëse Dhoma e Ulët mban seancë të mërkurën dhe të premten, rendi i ditës duhet të përfshijë edhe leximet e treta të propozim-ligjeve. Nëse nuk është vendosur ndryshe nga ana e Dhomës së Ulët, leximi i tretë i propozim-ligjeve bëhet ndërmjet orës 9:00 dhe 14:00 të mërkurën dhe të premten, të cilat janë të caktuara si ditë për seanca. Dhoma e Ulët gjithashtu mund të vendosë që të rezervojë kohë tjetër për këtë qëllim përveç nëse ka një kundërshtim nga të paktën dy grupe të deputetëve. Në rastin e tillë, nuk do të ketë votim. Dhoma e Ulët duhet të vendosë nëse ekziston mundësia e përfshirjes së leximit të tretë të propozim-ligjeve në rendin e ditës në seancë në një ditë tjetër. Nuk mund të merret vendim i tillë nëse të paktën dy grupe të deputetëve bëjnë kundërshtim. Çdo komision, grup i deputetëve ose deputet mund të propozojë që të ndryshojë ose të zgjerohet rendi i ditës i Dhomës. Rendi i ditës i Dhomës, duke përfshirë edhe ndryshimin apo zgjerimin e tij të mundshëm, votohet pa diskutim.

Gjatë seancës, Dhoma e Ulët mund të votojë, pa diskutim, ta ndryshojë radhën e shqyrtimit të ndonjë pike të caktuar të rendit të miratuar të ditës, ta ndryshojë rendin e ditës apo ta plotësojë atë. Arsyeimi i kërkesës për një votim të tillë nuk mund të zgjasë më shumë se 5 minuta; ndërsa kufizimi kohor nuk vlen për deputetët të paraparë në nenin 67. Fjalimi i deputetit mund të ndërpritet dhe përfundohet në mënyrën e përkrahur për përfundimin e fjalimit të deputetit pas vërejtjes së dhënë (neni 60). Rendi i miratuar i ditës i Dhomës së Ulët mund të zgjerohet gjatë seancës vetëm në raste të jashtëzakonshme. Dhoma e Ulët nuk mund ta shqyrtojë zgjerimin e tillë nëse të paktën dy grupe të deputetëve apo 20 deputetë bëjnë kundërshtim.

## STRUKTURA DHE DISPONUESHMËRIA E KALENDARIT

### **Si është rregulluar kalendari në aspekt juridik?**

Ekzistenca e kalendarit të Dhomës së Ulët nuk është e rregulluar nga aspekti juridik. Neni 46 i Rregullores përcakton se Komiteti Drejtues (organi më i lartë vetadministrues i Parlamentit) organizon dhe koordinon punën e të gjitha organeve të Parlamentit dhe e përcakton kohën e rezervuar për seancat e rregullta të Dhomës. Komiteti Drejtues arrin pajtueshmëri për një plan gjashtëmuajsh të aktiviteteve të Parlamentit. Plani bazohet në një cikël prej gjashtë javësh duke filluar me dy javë të dedikuara për seancat plenare, pastaj vjen një javë për mbledhjet e komisioneve, vijon e ashtuquajtura javë variabile (shpesh kjo është java e tretë për seancat plenare), pastaj java për mbledhjet e komisioneve dhe cikli përmbyllet me javën e dedikuar për praninë e deputetëve në njësitë e tyre zgjedhore.

Komiteti Drejtues, Kryetarit i propozon Propozim-rendin e ditës për një seancë të caktuar plenare të Parlamentit. Neni 54 i Rregullores rregullon procedurën e miratimit të rendit të ditës të mbledhjes së caktuar. Çdo komision, grup i deputetëve apo deputet, në fillim të ditës së seancës mund të propozojë ndryshim apo zgjerim të rendit të ditës.

#### **Cila është struktura e kalendarit dhe kush e propozon atë?**

Kalendari i seancave dakordohet dhe miratohet nga Komiteti Drejtues, që është organi më i lartë vetadministrues i Dhomës së Ulët, përgjegjës për organizimin e punës së Parlamentit. Vendimi për kalendarin është vendim autonom i organit vetadministrues. Kalendari u komunikohet aktorëve të tjerë të rëndësishëm dhe është i disponueshëm për qytetarët në ueb-faqen e Dhomës së Ulët.

#### **Kush e miraton kalendarin?**

Kalendarin e miraton Komiteti Drejtues, i cili paraqet edhe organin më të lartë vetadministrues të Dhomës së Ulët dhe përbëhet nga Kryetari e nënkryetarët dhe përfaqësuesit e partive politike, bazuar në parimin e përfaqësimit proporcional.

#### **Cila periudhë përfshihet me kalendar?**

Kalendari përfshin periudhë prej gjysmë viti. Rendi i ditës i seancave plenare prezantohet tërësisht dhe i njëjti përditësohet çdo ditë sipas votimit të Dhomës për ndryshimin e rendit të ditës. Rendi i ditës i komisioneve përfshin kohën konkrete të dedikuar për diskutimin e temave të caktuara.

#### **Si bëhet kalendari i disponueshëm për qytetarët?**

Kalendari, rendi i detajuar i ditës i seancave plenare, i komisioneve dhe komiteteve janë të disponueshëm në faqen e internetit të Dhomës së Ulët.

Figura 2. Orari gjashtëmuor i punës i Dhomës së Ulët (i disponueshëm vetëm në gjuhën çeke)<sup>6</sup>

## Harmonogram pravidelných akcí na 1. pololetí 2021

Týden kalend. roku	Datum	Týden týd. cyklu	Náplň
1.	<a href="#">4. - 10. 1.</a>	5	výbory (Čt 7. 1. - ORGV schvaluje pořad schůze)
2.	<a href="#">11. - 17. 1.</a>	6	poslanecký týden
3.	<a href="#">18. - 24. 1.</a>	1	Poslanecká sněmovna
4.	<a href="#">25. - 31. 1.</a>	2	Poslanecká sněmovna 1/
5.	<a href="#">1. - 7. 2.</a>	3	výbory
6.	<a href="#">8. - 14. 2.</a>	4	variabilní týden
7.	<a href="#">15. - 21. 2.</a>	5	výbory (Čt 18. 2. - ORGV schvaluje pořad schůze)
8.	<a href="#">22. - 28. 2.</a>	6	poslanecký týden 2/
9.	<a href="#">1. - 7. 3.</a>	1	Poslanecká sněmovna
10.	<a href="#">8. - 14. 3.</a>	2	Poslanecká sněmovna
11.	<a href="#">15. - 21. 3.</a>	3	výbory
12.	<a href="#">22. - 28. 3.</a>	4	variabilní týden 3/
13.	<a href="#">29. 3. - 4. 4.</a>	5	výbory (Čt 1. 4. - ORGV schvaluje pořad schůze) 4/
14.	<a href="#">5. - 11. 4.</a>	6	poslanecký týden 5/

## PËRMBAJTJA E KALENDARIT

Kalendari është ndërveprues dhe përmban informata javore të seancave plenare. Informatat tjera janë përfshirë në agjendën specifike javore të seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve.

Kalendari përfshin informata për punën e Dhomës së Ulët, apo më konkretisht:

- Mbledhjet e trupave të punës (komitete, komisione) janë të përfshira në kalendar; agjenda e punës e Kryetarit është përfshirë në një pjesë të veçantë.<sup>7</sup>
- Janë përfshirë vizitat apo takimet ndërkombëtare.
- Kalendari nuk përfshin takimet e grupeve të deputetëve.
- – Ngjarjet e hapura për qytetarët (seminaret, vizitat, ngjarjet kulturore) janë të disponueshme në kalendar dhe në faqen e internetit në një pjesë të veçantë.<sup>8</sup>

6 <https://www.psp.cz/sqw/hp.sqw?k=200>

7 Mgr. Radek Vondráček, projevy, tiskové zprávy, program. Dostupné z: <https://www.psp.cz/sqw/detail.sqw?id=6165>.

8 Veřejnost a média. Dostupné z: <https://www.psp.cz/sqw/hp.sqw?k=184>.

## SI JANË TË RREGULLUARA DISKUTIMET PARLAMENTARE?

### Diskutimi

Duke u bazuar në nenin 58 të Rregullores, deputetët duhet të paraqiten me shkrim për pjesëmarrjen e tyre në diskutim, qoftë te Kryetari i Dhomës së Ulët para fillimit, qoftë te kryesuesi i seancës në çdo kohë para përfundimit të saj. Deputetët gjithashtu mund të paraqiten për diskutim edhe me ngritjen e dorës. Prioritet u jepet atyre deputetëve të cilët për diskutim janë paraqitur me shkrim.

Që në fillim, kryesuesi i lexon emrat e të gjithë folësve të paraqitur. Pasi të fillojë diskutimi, kryesuesi i jep leje referuesit që t'i drejtohet Parlamentit kur të kërkojë ai. Kryesuesi duhet t'i mundësojë çdo deputeti të caktuar që ta paraqesë mendimin e grupit të deputetëve që të flasë në çdo kohë para përfundimit të diskutimit. Mund të flasin vetëm deputetët të cilëve u lejohej nga kryesuesi. Nëse një deputet nuk është i pranishëm në sallë kur është radha e tij të flasë, ai e humb të drejtën e tij të fjalës në atë moment. Nëse deputeti nuk është i pranishëm edhe para përfundimit të diskutimit, e humb plotësisht të drejtën për të marrë fjalë.


Sipas nenit 59, Parlamenti mund të vendosë pa diskutim ta kufizojë kohën për çdo fjalim për çfarëdo lloj çështje. Kufizimi minimal i kohës duhet të jetë të paktën dhjetë minuta. Ky kufizim, megjithatë, nuk duhet të zbatohet për deputetët e autorizuar për të paraqitur mendimet e grupit të deputetëve. Dhoma e Ulët mund të vendosë pa diskutim që çdo deputet të mund të flasë për të njëjtën çështje më së shumti dy herë. Në bazë të nenit 60, çdo deputet mund të kërkojë që të paraqesë një koment faktik në përgjigje të debatit që po zhvillohet. Komentet faktike përfshijnë gjithashtu edhe propozimet procedurale lidhur me mënyrën e diskutimit të çdo pike të rendit të ditës. Megjithatë, komentet faktike nuk duhet të përfshijnë mendimet faktike për çështjet e diskutuara. Deputetët i cili ka për qëllim të paraqesë një koment faktik duhet t'i mundësohet të flasë menjëherë pasi që të përfundojë folësi aktual. Koha për prezantim të një komenti faktik dhe për replikën për një koment të tillë faktik nuk mund të jetë më e gjatë se 2 minuta. Neni 63 i ofron deputetëve të drejtën që gjatë diskutimit, të parashirojnë kërkesë lidhur me propozimet që po shqyrtohen. Ato duhet të jenë në lidhje me aspektet e caktuara të çështjes që është objekt i diskutimit dhe duhet të specifikojnë në mënyrë të qartë vendimin të cilin duhet ta miratojë Dhoma e Ulët. Kryetari mund të kërkojë nga deputeti ta arsyetojë kërkesën ose ta dorëzojë atë me shkrim.

### Votimi

Votimi për pikat e rendit të ditës, duke përfshirë edhe propozim-ligjet, është pjesë e diskutimit.



# ESTONIA




Estonia ka një parlament njëdhomësh, i njohur si Riigikogu. Sipas Aktit për rregulloren dhe rregullat e brendshme të Riigikogu ("Rregullorja"), seancat në Riigikogu mbahen në kuadër të dy sesioneve të përgjithshme gjatë vitit (pranveror dhe vjeshtor). Sesioni pranveror fillon të martën e dytë të muajit janar dhe zgjat deri të enjten e tretë të muajit qershor. Sesioni vjeshtor fillon të martën e dytë të muajit shtator dhe zgjat deri të enjten e tretë të muajit dhjetor. Në muajt janar, qershor, korrik, gusht, shtator dhe dhjetor mund të mbahen seanca të jashtëzakonshme.

Gjatë sesionit të rregullt, seancat organizohen në një cikël prej katër javësh, - seancat plenare mbahen nga e hëna në të enjte në tre javët e para. Java e katërt është e lirë në të cilën deputetët mund t'ia kushtojnë kohën komunikimit me qytetarët të njësive të tyre zgjedhore (shihni Figurën 3). Rregullorja përcakton këto dispozita në detaje në § 45-§47.<sup>9</sup>

Kalendari që tregon ciklin e seancave plenare është i disponueshëm në faqen kryesore të internetit të Riigikogu.<sup>10</sup>

Figura 3. Kalendari Riigikogu për vitin 2021 (i disponueshëm vetëm në gjuhën estoneze)



Seanca plenare dhe mbledhjet e komisioneve mbahen nga e hëna në të enjte. Rregullorja përcakton afatet kohore për seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve (duke përfshirë edhe mbledhjet e Komisionit të Punëve të Jashtme dhe Komisionit të Çështjeve Evropiane), dhe takimet e grupeve të deputetëve të partive parlamentare.


Megjithatë, nuk ka asnjë dispozitë me të cilën parashihet kalendari (agjenda e punës së Parlamentit) në Rregullore. Sidoqoftë, Rregullorja parasheh procesin e përcaktimit të rendit të ditës dhe miratimin e tij (shih më poshtë).

9 Riigikogu Rules of Procedure and Internal Rules Act. Dostupné z: <https://www.riigiteataja.ee/en/eli/512032015002/consolide/current>.

10 XIV Riigikogu töögraafik. Dostupné z: <https://www.riigikogu.ee/wpcms/wp-content/uploads/2015/02/RK2021.pdf>.

Krahas ciklit për punën e Parlamentit, kalendari dhe rendi i ditës që do të diskutohet në nivele të seancave plenare dhe komisioneve publikohen në faqen kryesore të *Riigikogu*. Kalendari mundëson kërkimin e informatave sipas kritereve të ndryshme (për shembull aktorët siç janë seanca plenare, komisionet, këshilli i *Riigikogu*). Kalendari gjithashtu përfshin një lidhje të drejtpërdrejtë me informacione thelbësore për rendin e ditës të diskutuar në kohën dhe minutën e saktë.<sup>11</sup>

**Figura 4. Organizimi i javëve të seancave (e disponueshme vetëm në gjuhën estoneze)**



Rregullorja gjithashtu përcakton dispozitën për ndryshimin e agjendës së punës dhe seancave shtesë të Riigikogu (§ 48 dhe § 49). Sipas § 48 të Rregullores, ndryshimi i agjendës së punës bëhet sipas një procedurë shumë rigorozë në të cilën ndryshimi bazohet në një vendim të miratuar me një shumicë prej dy të tretash të deputetëve. Rregullorja nuk përcakton bazën sipas së cilës është diskutuar dhe përfundimisht është miratuar vendimi. Veç tjerash, gjithashtu mund të mbahet një mbledhje shtesë sipas dispozitës së § 49. Mbledhja shtesë mbahet sipas vendimit të Këshillit (Kryetari dhe dy nënkryetarët e *Riigikogu* të cilët janë zgjedhur në seancën e parë të legjislaturës së re të *Riigikogu*).

<sup>11</sup> Kalender. Dostupné z: <https://www.riigikogu.ee/tegevus/kalender-ja-eelinfo/>.

Krahas kësaj, *Riigikogu* mund të mbajë seancë të jashtëzakonshme, e cila thirret me propozim të Qeverisë, Presidentit të Republikës ose të paktën një të pestës të deputetëve të *Riigikogu*. Seanca e jashtëzakonshme mund të mbahet edhe gjatë periudhës të sesionit të rregullt.

Numri i ditëve të seancave në çdo periudhë zgjedhore varion nga 453 në 459. Në periudhën e fundit zgjedhore 2015-2019, *Riigikogu* ka mbajtur seanca të rregullta në një total të përgjithshëm prej 1,411 orëve.<sup>12</sup>

## PËRCAKTIMI I RENDIT TË DITËS TË RIIGIKOGU

Organizimi i punës i Parlamentit në dy sesionet e rregullta kërkon një sistem të qartë dhe solid të përcaktimit të rendit të ditës.

Rregullorja parasheh faza të ndryshme në procesin e përcaktimit të rendit të ditës:

- Përcaktimi i rendit të ditës (mbledhja dhe vendosja e pikave për shqyrtim);
- Shpërndarja e rendit të ditës;
- Miratimi përfundimtar i rendit të ditës para shqyrtimit.

Duke pasur parasysh llojin e seancës/mbledhjes në të cilën realizohet procesi i përcaktimit të rendit të ditës, çdo hap është i ndryshëm.

Rendi i ditës për çdo **mbledhje të rregullt** (plenare) (një javë pune) përgatitet nga Këshilli i *Riigikogu* jo më vonë se në ora 15:00 të enjten e javës që është para javës së punës (§ 53 (2)). Rregullorja gjithashtu përcakton se pikat për shqyrtim në seancë plenare mund të propozohen nga komisionet, por edhe nga marrëveshjet e arritura me subjektet, të cilave u është paraqitur interpelancë dhe janë të përfshira në përgjigjet e tyre. Radha e pikave për diskutim duhet të ndjekë logjikën për t'i dhënë prioritet pikave që janë paraqitur në fillim – d.m.th. pikat që nuk janë shqyrtuar në mbledhjen e mëparshme duhet të radhiten në krye të rendit të ditës në javën e ardhshme të punës.

Në fund të javës së punës, anëtarëve duhet t'u shpërndahet rendi i ditës për javën e ardhshme (§ 54 (1)). Pasi që të shpërndahet, rendi i ditës mund të ndryshohet vetëm nëse asnjë grup i deputetëve nuk kundërshton propozimin e tillë. Të drejtën e jashtëzakonshme për heqjen e një pike nga rendi i ditës e ka vetëm parashtruesi i një propozim-ligji, parashtruesi i një projektrezolute apo kryetari i komisionit.

---

12 *RIIGIKOGU XIII KOOSSEIS*. Dostupné z: <https://www.riigikogu.ee/wpcms/wp-content/uploads/2014/11/XIII-Riigikogu-statistikakogumik.pdf>.

Pastaj rendi i ditës miratohet nga Asambleja plenare në seancën e parë të javës së punës ose në fillim të seancës shtesë. Rendi i ditës në *Riigikogu* mund të ndryshohet edhe paraprakisht vetëm nëse asnjë grup i deputetëve nuk e kundërshton qëllimin.

Pasi që të miratohet rendi i ditës në seancë plenare, Kryetari i *Riigikogu* mund ta ndryshojë rendin e ditës nën rrethana të caktuara (§ 56). Këto rrethana lidhen me funksionin e mbikëqyrjes parlamentare (për shembull mocioni për të shprehur mosbesim në Qeverinë, emërimi i kandidatit për postin e Kryeministrit), funksionin ligjvënës (miratimi i serishëm i projektligjit të refuzuar nga Presidenti i Republikës, një projektligj që miraton ose shfuqizon një dekret presidencial), e të tjera. Të gjithë pikat e përfshira në rendin e ditës janë me propozim të Kryetarit të *Riigikogu*. Megjithatë, një ligj i ri nuk bën pjesë në përjashtimet që asambleja plenare mund ta pranojë për shqyrtim të ndryshuar. Rrjedhimisht, Rregullorja përmban dispozita relativisht strikte që pamundësojnë futjen e një iniciative ligjvënëse të prezantuar nga deputeti i *Riigikogu* pa vënien e duhur të rendit të ditës dhe miratimin formal.

Këshilli i *Riigikogu* gjithashtu vendos dhe përcakton rendin e ditës për **seancën shtesë**. Megjithatë, nuk ka një kufizim të saktë për atë se kur rendi i ditës u shpaloet deputetëve të tjerë. Megjithatë, dispozita për seancën shtesë (§ 47) përcakton se Kryetari njofton deputetët për seancën plotësuese të paktën tri ditë para datës në të cilën është planifikuar të mbahet seanca plenare. Kur njoftohen deputetët, Kryetari gjithashtu i informon ata edhe për rendin e ditës të seancës (§ 54 (2)).

Qëllimi për mbajtjen e seancës shtesë nuk është përkufizuar saktësisht. Megjithatë, Këshilli i *Riigikogu* mund të thërrasë seancë plenare të shqyrtojë pikat të cilat nuk janë shqyrtuar ende në seancat e rregullta në fund të sesionit të rregullt.

Rendin e ditës për **seancën e jashtëzakonshme** e përgatit propozuesi për thirrjen e seancës (d.m.th. Qeveria, Presidenti i Republikës ose një e pesta e deputetëve të *Riigikogu*). Rendi i ditës i seancës së jashtëzakonshme duhet të shpallet bashkë me njoftimin për thirrjen e saj nga propozuesi. Rendi i ditës nuk miratohet në seancë plenare. Këshilli i *Riigikogu* duhet të përkufizojë agjendën e punës të seancës së jashtëzakonshme dhe të paktën shumica e deputetëve të *Riigikogu* duhet të votojnë për. Megjithatë, ka edhe një kufizim tjetër për seancën e jashtëzakonshme. Kuorumi i deputetëve të pranishëm gjatë mbledhjes shtesë dhe seancës së jashtëzakonshme është caktuar të jetë të paktën gjysma e deputetëve të *Riigikogu*.

Dispozitat e rregullores japin një kornizë rigide për transparencën e procesit të përcaktimit të rendit të ditës në Estoni. Gjatë sesionit të rregullt, ngarkesa e punës të *Riigikogu* është vendosur në mënyrë të parashikueshme në seancat e rregullta sipas radhës. Shqyrtimi lidhur me pika të caktuara të rendit të ditës bëhet në mënyrë të njëpasnjëshme. Gjithashtu duhet theksuar se agjenda javore i nënshtrohet miratimit (në mënyrë alternative refuzimit dhe ndryshimit) sipas dispozitave specifike të Rregullores. Megjithatë, Rregullorja nuk lejon futjen e një pike të re në rendin e miratuar të ditës për miratimin e një ligji të ri. Me këtë, përcaktimi i rendit të ditës është relativisht rigid. Për më tepër, Rregullorja gjithashtu përcakton kufizime relativisht rigoroze për ndryshimin e programit të punës të *Riigikogu*.

## SI JANË TË RREGULLUARA DISKUTIMET NË PARLAMENT?

Deputetët e *Riigikogu* kanë kohë të kufizuar për fjalimin e tyre. Sipas Rregullores, ka një kufizim prej pesë minutash për fjalimin e parë; çdo fjalim i ardhshëm mund të zgjasë vetëm dy minuta. Pas miratimit, kjo mund të zgjatet deri në 3 minuta.

### Votimi

Nuk ka kohë specifike për votimin e pikave të rendit të ditës.

## STRUKTURA DHE DISPONUESHMËRIA E KALENDARIT

### Si është rregulluar kalendari në aspekt juridik?

Nuk ka dispozitë ligjore për kalendarin e Parlamentit me qëllim të informimit të qytetarëve.

### Si është struktura e kalendarit dhe kush e propozon atë?

Kalendari përmban informata për punën e seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve. Rendi i ditës i kalendarit përcaktohet në mënyrë automatike sipas diskutimit që mbahet për pikat në organet relevante parlamentare (shih më lart). Këshilli i *Riigikogu* është formalisht përgjegjës për përpilimin dhe shpërndarjen e kalendarit/rendit të ditës.

### Kush e miraton kalendarin?

Kalendari pasqyron procedurën e punës së Riigikogu. Duke pasur parasysh sesionet gjysmë vjetore, periudha e punës së Riigikogu është përcaktuar me Rregullore. Këshilli i Riigikogu përgatit paraprakisht rendin e ditës për të cilin duhet të diskutohet. Rendi i ditës që do të diskutohet në javën përkatëse duhet të miratohet nga seanca plenare në fillim të javës së punës.

### Cila periudhë përfshihet me kalendar?

Programi i ciklit parlamentar përfshin periudhën prej një viti. Kalendari në faqet e internetit të Riigikogu mbulon të gjitha ngjarjet. Rendi i ditës i seancës plenare duhet të shpallet dy ditë pune para diskutimit. Kalendari (si një vegël e TI-së) mundëson filtrimin e ngjarjeve sipas kohës dhe aktorëve.


**Në ç'mënyrë kalendari bëhet i disponueshëm për qytetarët?**

Kalendari është i disponueshëm për qytetarët nëpërmjet faqes së internetit të Riigikogu (shih më sipër).

**Përmbajtja e kalendarit**

- Mbledhjet e trupave të punës (komitetet, komisionet) janë të përfshira në kalendar.
- Agjenda e punës e Kryetarit nuk është përfshirë në mënyrë specifike; megjithatë është përfshirë agjenda e Këshillit të *Riigikogu*.
- Janë përfshirë vizitat ose takimet ndërkombëtare.
- Nuk janë përfshirë takimet e grupeve të deputetëve; megjithatë, ka informacion të disponueshëm për diskutimet e liderëve të partive.
- Ngjarjet e hapura për qytetarët janë të disponueshme përmes kalendarit (seminare, vizita, ngjarje kulturore). Për më tepër, faqet e internetit gjithashtu përmbajnë vegla të TI-së për informim më të mirë të votuesve dhe komunikimin e tyre me deputetët e *Riigikogu*.

# GJERMANIA



Bundestagu gjerman është në punime të përhershme. Neni 39 i Ligjit themelor gjerman thekson se “*Bundestagu* vendos kur do t’i ndërpresë dhe vazhdojë seancat e tij.” Mandati zgjedhor apo legjislatura e *Bundestagut* është katër vjet dhe është në punime të përhershme gjatë gjithë legjislaturës së tij, që përputhet me mandatin zgjedhor.



## PËRCAKTIMI I RENDIT TË DITËS

Sipas rregullës nr. 30 të Rregullores, rendi i ditës i seancës plenare të *Bundestagut*, si dhe data e takimit, duhet të miratohet nga Këshilli i Pleqve, përveç nëse *Bundestagu* ka vendosur paraprakisht që t'ia besojë këtë Presidentit. Propozim rendi i ditës duhet t'i komunikohet deputetëve të *Bundestagut*, Këshillit Federal dhe Qeverisë Federale.

Rendi i ditës do të konsiderohet se është miratuar në kohën kur ka filluar pika e parë. Paraprakisht, çdo deputet i Kuvendit mund të propozojë ndryshim të rendit të ditës nëse propozimi i tij është dërguar Kryetarit deri në orën 18:00 të ditës paraardhëse. Rendi i miratuar i ditës mund të ndryshohet vetëm nëse grupi parlamentar ose grupi prej 5% i deputetëve të pranishëm pajtohet me propozimin. *Bundestagu* mund të vendosë që të heqë ndonjë pikë nga rendi i ditës gjatë gjithë kohës së seancës.

## STRUKTURA DHE DISPONUESHMËRIA E KALENDARIT

### Si është rregulluar kalendari në aspekt juridik?

Kalendari i *Bundestagut* gjerman nuk është i rregulluar me ligj. Rregulla 20 e Rregullores ka të bëjë me përcaktimin e rendit të ditës për një seancë të caktuar. Sipas kësaj rregulle "data dhe rendi i ditës i çdo mbledhjeje të *Bundestagut* duhet të dakordohet në Këshillin e Pleqve, përveç nëse *Bundestagu* ka marrë tashmë një vendim për këtë ose Kryetari përcakton atë në bazë të kompetencave të veta." Kryetari, në kuadër të kompetencave të veta e përcakton datën dhe rendin e ditës të seancës nëse *Bundestagu* e autorizon atë ose nëse është i pamundësuar për të marrë një vendim, për ndonjë arsye që është e ndryshme nga mungesa e kuorumit.

Në praktikë, Këshilli i Pleqve cakton paraprakisht agjendën për datat e mbajtjes së seancave në bazë javore paraprakisht për vitin e ardhshëm (shihni Figurën 5). Kalendari i seancave përpilohet në bazë të datave të paracaktuara nga Këshilli i Pleqve.

Rendi i ditës i seancave plenare përcaktohet nga Këshilli i Pleqve pak kohë para se të mbahen të njëjtat, dhe për këtë vendoset brenda një jave para se të mbahet seanca. Rendi i propozuar i ditës iu komunikohet deputetëve, Këshillit Federal (*Bundesratit*), dhe Qeverisë Federale. Nëse nuk ka asnjë kundërshtim, rendi i propozuar i ditës quhet i miratuar pas fillimit të diskutimit të pikës së parë të seancës plenare. Çdo javë e përcaktuar për seancat plenare konsiderohet dhe numërohet si seancë e veçantë plenare

### Si është struktura e kalendarit dhe kush mund të propozojë atë?

Kalendari i seancave dakordohet dhe miratohet nga Këshilli i Pleqve, që është organi më i lartë vetadministrues i *Bundestagut*, përgjegjës për organizimin e punës të Parlamentit. Rrjedhimisht, vendimi për kalendarin është një vendim autonom i organit vetadministrues. Kalendari iu komunikohet aktorëve të tjerë relevantë për planifikimin e aktiviteteve lidhur me *Bundestagun*. Kalendari publikisht është i arritshëm për qytetarët në faqen e internetit të *Bundestagut*.

### Kush e miraton kalendarin?

Organi vetadministrues i *Bundestagut* përbëhet nga përfaqësuesit e partive politike në bazë të parimit proporcional.

### Cila periudhë përfshihet me kalendari?

Kalendari përfshin periudhën kohore prej gjysmë viti, dhe për javën e ardhshme prezantohet rendi i ditës i seancave plenare dhe mbledhjeve të komisionit. Rendi i ditës i seancës plenare dhe mbledhjes së komisionit përmban kornizë konkrete kohore (një orë) për të diskutuar temën e caktuar..

### Si bëhet kalendari i arritshëm për qytetarët?

Kalendari, rendi i detajuar i ditës i seancës plenare, i komisioneve, dhe organeve të tjera politike të *Bundestagut*, janë të disponueshme në faqen e internetit të *Bundestagut*.<sup>13</sup> Rendi i ditës i komisionit publikohet në faqen e tyre përkatëse të internetit.<sup>14</sup>

Figura 5. Kalendari parlamentar i Bundestagut (i disponueshëm vetëm në gjuhën gjermane)

13 Tagesordnung und Sitzungsverlauf. Dostupné z: <https://www.bundestag.de/tagesordnung>.

14 Ausschüsse. Dostupné z: <https://www.bundestag.de/ausschuesse>.

### **Përmbajtja e kalendarit**

Kalendari përmban informata vetëm për seancat plenare në nivel javor. Informatat e tjera janë përfshirë në agjendën konkrete javore të seancave plenare dhe komisioneve. Informatat të cilat përfshin kalendari janë si në vijim:

- Mbledhjet e trupave të punës (komitetet, komisionet) nuk janë të përfshira në kalendar, por rendi i ditës është i disponueshëm.
- Agjenda e ditës e Kryetarit nuk është përfshirë.
- Vizitat ose takimet ndërkombëtare nuk janë përfshirë.
- Takimet e grupeve të deputetëve nuk janë përfshirë.
- Në kalendar nuk janë të përfshira ngjarjet e hapura për qytetarët (seminaret, vizitat, ngjarjet kulturore), por janë të disponueshme për publikun në një pjesë të caktuar në ueb-faqe.<sup>15</sup>

### **Në ç'mënyrë janë të rregulluara diskutimet në parlament?**

Sipas rregullës 35 të Rregullores së punës, formën dhe kohëzgjatjen e diskutimit e përcakton Këshilli i Pleqve. Veç kësaj, edhe diskutimi për pika të caktuara të negociatave përcaktohet nga Këshilli i Pleqve.

Nëse një anëtar i Qeverisë ose i Këshillit Federal apo një person i autorizuar prej tyre flet më gjatë se 20 minuta, grupi i deputetëve që dëshiron të paraqesë një mendim të ndryshëm, mund të kërkojë periudhën e njëjtë kohore për një përfaqësues të grupit të tij parlamentar.

Diskusimi për propozim-ligjet zhvillohet nëpërmjet tre leximeve.

### **Diskusimi për pikat e rendit të ditës**

Nëse Pleqtë nuk arrijnë marrëveshje, koha e fjalimit të një folësi nuk mund të tejkalojë 15 minuta. Me kërkesë të grupit parlamentar, një nga pjesëtarët e grupit mund të mbajë fjalim deri më 45 minuta. Kryetari mund të zgjasë kohën e caktuar për fjalim nëse e konsideron thelbësore zhvillimin e debatit ose rëndësinë e tij.

Nëse një deputet i Bundestagut tejkalon kohën e caktuar të fjalimit të tij, Kryetari, me vërejtje paraprake, do t'ia heqë të drejtën e fjalës.

Diskusimi mbi propozim-ligjet është i kufizuar në pjesën e përgjithshme të tij, dhe është i përqendruar më shumë në pjesët e veçanta të propozim-ligjit.


### **Votimi**

Votimi, lidhur me pikat e rendit të ditës, sikurse edhe propozim-ligjet, konsiderohet pjesë e diskutimit.

---

<sup>15</sup> Besuchen Sie den Deutschen Bundestag. Në dispozicion në: <https://www.bundestag.de/besucher>.

# REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Sipas nenit 66 të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi është në punime të përhershme. Legjislatura e Kuvendit është katër vjeçar dhe punimet janë të përhershme për periudhën që përputhet me mandatin zgjedhor.

## PËRCAKTIMI I RENDIT TË DITËS

Kryetari i Kuvendit duhet të thërrasë punimet e Parlamentit në bazë të nenit 67 të Rregullores. Neni 68 përcakton se vendimi për thirrjen e punimeve të Parlamentit bashkë me propozim rendin e ditës dhe dokumentet për çështjet në pikat e rendit të ditës, duhet t'i dorëzohen deputetit të Kuvendit së paku dhjetë ditë pune para ditës së përcaktuar për mbajtjen e seancës. Ka mundësi që të thirren mbledhjet e komisioneve dhe seanca plenare në të njëjtën ditë.

Kryetari e propozon rendin e ditës, ndërsa Kuvendi duhet ta përcaktojë atë në fillim të seancës. Kryetari i Kuvendit duhet të përfshijë në propozim rendin e ditës pikat të cilat kanë përmbushur kushtet përkatëse të përcaktuara me Rregullore (Neni 69 i Rregullores).

Sipas nenit 70 të Rregullores deputeti ose Qeveria, mund të propozojnë inkorporimin e pikave në rendin e ditës, vetëm në rast të nevojës urgjente dhe të paprolongueshme, derisa të miratohet rendi i ditës i seancës. Propozimi duhet të arsyetohet me shkrim.

Deputeti dhe Qeveria pas thirrjes së seancës, mund të propozojnë shtyrjen apo tërheqjen e pikave të caktuara të rendit të ditës dhe për këtë të japin arsyetim.

Neni 76 i Rregullores thotë se para përcaktimit të rendit të ditës, Kryetari i Kuvendit i njofton deputetët për propozimet që kanë të bëjnë me inkorporimin, shtyrjen ose tërheqjen e pikave të propozim-rendit të ditës, në përputhje me nenin 70 të kësaj Rregulloreje. Pastaj, në bazë të nenit 77, Kuvendi pa diskutim deklarohet për çdo propozim që ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e propozuar të rendit të ditës, dhe për propozim rendin e ditës të seancës në përgjithësi.

## STRUKTURA DHE DISPONUESHMËRIA E KALENDARIT

### Si është rregulluar kalendari në aspekt juridik?

Kalendari i Kuvendit nuk është i rregulluar në aspektin juridik. Sipas nenit 24 të Ligjit për Kuvendin, çdo të hënë, Kryetari i Kuvendit thërret koordinim të rregullt me nënkryetarët dhe koordinatorët e grupeve të deputetëve me qëllim të harmonizimit të agjendës javore të trupave të punës së Kuvendit. Gjithashtu, nuk ka asnjë dispozitë ligjore që rregullon planifikimin afatgjatë të aktiviteteve të Kuvendit, d.m.th. as plan gjysmë vjeçar e as për një cikël më të shkurtër disa javorë.

### Si është struktura e kalendarit dhe kush e propozon atë?

Sipas nenit 36 të Ligjit për Kuvendin, ditët e premte janë përcaktuar si ditë për kontakt të deputetëve me qytetarët, dhe për këtë shkak, si rregull Kuvendi nuk mban seanca plenare dhe mbledhje të komisioneve.

Rendi i ditës është i disponueshëm.

### Kush e miraton kalendarin?

Miratimi i kalendarit nuk është i paraparë me ligj, dhe duke pasur parasysh këtë fakt, nuk është e qartë se kush është kompetent për të miratuar kalendarin e strukturuar. Kalendarin mund të miratohet në një takim të rregullt koordinues që mbahet te Kryetari i Kuvendit me nënkryetarët dhe koordinatorët e grupeve të deputetëve.


### Cila periudhë mbulohet nga kalendarin?

Informata nuk është e disponueshme.

### Në ç'mënyrë bëhet i disponueshëm kalendarin për qytetarët?

Kalendarin është i disponueshëm në internet në ueb-faqen e Kuvendit.

Figura 6. Kalendarin në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>16</sup>



### Përmbajtja e kalendarit

Kalendarin është ndërveprues dhe përmban informata për aktivitetet e muajit në vijim. Kalendarin përfshin informata për punimet ditore të Kuvendit, në mënyrë më specifike:

- Mbledhjet e trupave të punës (komitetet, komisionet) janë përfshirë në kalendar; agjenda e ditës e Kryetarit të Kuvendit jepet në një pjesë të veçantë.<sup>17</sup>
- Janë përfshirë vizitat ose takimet ndërkombëtare.
- Kalendarin nuk përfshin takimet e grupeve të deputetëve.

<sup>16</sup> <https://www.sobranie.mk/home-en.nspx>.

<sup>17</sup> <https://www.sobranie.mk/activities-2014.nspx>.

## SI JANË TË RREGULLUARA DISKUTIMET PARLAMENTARE?

### Diskutimi

Sipas nenit 78 të Rregullores, diskutimi për pikat e rendit të ditës realizohet në pajtim me radhën e përcaktuar të rendit të ditës. Kuvendi nuk mund të diskutojë për çështjet për të cilat komisioni amë dhe komisioni juridik-ligjvënës nuk ka marrë qëndrim, nëse me Rregullore nuk është paraparë ndryshe. Kuvendi nuk mund të diskutojë për propozim-ligjin me të cilin bëhet harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian nëse propozim-ligjin nuk e shqyrton Komisioni për Çështje Evropiane i Kuvendit.

Debati zgjat derisa të shterohet lista e deputetëve të cilët janë paraqitur për fjalë. Deputetët, paraqiten për fjalë brenda një minute pas hapjes së diskutimit. Lista e deputetëve nuk mund të ndryshohet dhe të plotësohet derisa zgjat diskutimi. Neni 86 i Rregullores përcakton kufizimin kohor të fjalimeve. Deputeti mund të marrë fjalë vetëm një herë me kohëzgjatje prej më së shumti dhjetë minuta, ndërsa i njëjti kufizim vlen për raportuesin e Trupit amë të punës. Koordinatori i grupit të deputetëve ose njëri deputet i caktuar nga grupi i deputetëve apo nga koordinatori i grupit të deputetëve dhe propozuesi mund të flasë më shumë se një herë por jo më shumë se 15 minuta gjithsej.


Propozuesi dhe koordinorët e grupeve të deputetëve mund të paraqiten të marrin fjalë edhe derisa zgjat diskutimi. Kryetari i Kuvendit konstaton se diskutimi është mbyllur pasi sheh se lista e deputetëve të paraqitur për fjalë është shteruar. Kuvendi mund ta mbyll diskutimin për çdo pikë të rendit të ditës duke:

- miratuar aktin,
- miratuar konkluzionin, ose
- kaluar thjeshtë në pikën e ardhshme.

### Votimi

Votimi për pikat e rendit të ditës, duke përfshirë dhe propozim-ligjet, është pjesë e debatit.

# SLLOVAKIA



Këshilli Nacional i Republikës Sllovaqe është në punime të përhershme. Neni 82 i Kushtetutës Sllovaqe thekson se “Këshilli Nacional i Republikës Sllovaqe është vazhdimisht në punime.” Legjislatura e Këshilli Nacional zgjidhet për periudhë katërvjeçare, ndërsa punimet e Këshillit Nacional janë të përhershme për periudhën që përputhet me mandatin zgjedhor..



## PËRCAKTIMI I RENDIT TË DITËS

Sipas nenit 17 të Rregullores, Kryetari i Këshillit Nacional thërret seancat dhe e cakton vendin, ditën, dhe kohën dhe propozon rendin e ditës të seancës. Në bazë të nenit 24, Këshilli Nacional duhet të diskutojë dhe të votojë në fillim të çdo seance për rendin e ditës të propozuar nga Kryetari. Çdo deputet mund të paraqesë propozim për të ndryshuar rendin e ditës.

Ditë të zakonshme për mbajtjen e seancave të Këshillit Nacional janë të martat, të mërkurat, të enjtet dhe të premtet. Dita e parë e seancës fillon në orën 13:00, përveç nëse nuk është caktuar ndryshe nga Kryetari. Ditët vazhduese të seancave fillojnë në orën 09:00, dhe përfundojnë jo më vonë se në orën 19:00, ose në orën 16:00 të premtëve, përveç nëse vendoset ndryshe nga Këshilli Nacional.

## SI JANË TË RREGULLUARA DISKUTIMET PARLAMENTARE

### Diskutimi

Deputetët që dëshirojnë të marrin pjesë në diskutim për pikën e rendit të ditës duhet ta shënojnë emrin e tyre në listën e folësve vetëm pas miratimit të rendit të ditës nga Këshilli Nacional. Pasi të përfundojë fjalimi i folësve të listës, deputetët tjerë mund të kërkojnë të marrin fjalë. Kryesuesi u jep fjalën të gjithë folësve sipas radhës që janë paraqitur. Deputetët e autorizuar nga grupi i partive parlamentare duhet të flasin në fillim, me kusht që emrat e tyre të jenë shënuar në listë. Çdo grup i partive parlamentare duhet të autorizojë vetëm një deputet të flasë në emër të asaj partie. Gjatë diskutimit, raportuesi dhe propozuesi mund të marrin fjalën sa herë që ata kërkojnë të flasin. Kryetari dhe nënkryetarët e Këshillit Nacional, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë mund të marrin fjalën sa herë që ata kërkojnë një gjë të tillë.

Këshilli Nacional, me kërkesë të të paktën dy grupeve të partive parlamentare, mund të vendosë të caktojë një kufizim kohor për diskutim për një pikë të caktuar në rendin e ditës të Këshillit Nacional. Propozimi i tillë duhet të dorëzohet në fillim të debatit për këtë pikë në rendin e ditës të seancës të Këshillit Nacional. Propozimet e dorëzuara më vonë nuk do të merren parasysh. Kufizimi kohor për diskutim nuk duhet të jetë më pak se 12 orë. Në rast se Këshilli Nacional merr vendim për të vendosur një kufizim kohor, Kryetari duhet të ndajë kohën e caktuar për diskutim ndërmjet grupeve të partive parlamentare dhe deputetëve të cilët nuk janë anëtarë të grupeve të partive parlamentare në mënyrë proporcionale sipas numrit të deputetëve.

Këshilli Nacional mund të marrë vendim, pa diskutim, që të vendos një kufizim kohor për fjalim. Kufizimet e tilla nuk duhet të jenë më pak se dhjetë minuta, ose njëzet minuta në rastin e folësve të autorizuar nga grupi i partive parlamentare

Gjatë diskutimit, çdo deputet mund të propozojë amendament për çështjet që diskutohen. Çdo amendament duhet të jetë me shkrim dhe të formulohet siç duhet.

## STRUKTURA DHE DISPONUESHMËRIA E KALENDARIT

### Si është rregulluar kalendari në aspekt juridik?

Kalendari i Këshillit Nacional të Sllovakisë nuk është i rregulluar në aspektin juridik. Sipas pjesës 66 të Rregullores “*Gremiumi*” i deputetëve i përbërë nga deputetët e deleguar nga grupet e deputetëve në bazë të parimit proporcional duhet të marr në shqyrtim çështjet e natyrës politike dhe procedurale në lidhje me aktivitetet e Këshillit Nacional dhe organeve të tij. *Gremiumi* është organi më i lartë vetadministrues i Këshillit Nacional që diskuton çështjet që janë relevante për funksionimin e Këshillit Nacional.

Neni 24 i Rregullores thotë se rendi i ditës i seancës plenare propozohet nga Kryetari i Këshillit Nacional për shqyrtim para fillimit të seancës. Rendi i ditës i propozuar mund të ndryshohet me propozim të një deputeti individual, grupit të deputetëve ose grupi parlamentar.

Rendi i ditës (kur diskutohet një çështje e caktuar) është i parashikueshëm meqenëse Këshilli Nacional vendos për kohën e diskutimit dhe votimin (përveç çështjeve procedurale) të cilat përqendrohen në kohën e caktuar.

### Si është struktura e kalendarit dhe kush mund të propozojë atë?

Kalendari i seancave dakordohet nga ana e *Gremium-it* që është organi më i lartë vetadministrues i Këshillit Nacional, përgjegjës për organizimin e punës të Parlamentit dhe palëve tjera të përfshira, duke përfshirë administratën e Parlamentit. Kështu, vendimi për kalendarin është një vendim autonom i Parlamentit. Kalendari iu komunikohet aktorëve të tjerë relevantë për planifikimin e aktiviteteve që lidhen me Këshillin Nacional. Kalendari është publikisht i disponueshëm për qytetarët në faqen e internetit të Këshillit Nacional.

### Kush e miraton kalendarin?

Nuk ka procedura zyrtare për miratimin e kalendarit. Kalendari vjetor miratohet në nivel të *Gremium-it* në bashkëpunim me administratën e Parlamentit në fund të vitit për kalendarin e vitit të ardhshëm.


### Cila periudhë mbulohet nga kalendari?

Kalendari mbulon një periudhë një vjeçare.

### Në ç'mënyrë kalendari është i disponueshëm për qytetarët?

Kalendari, rendi i detajuar i ditës i seancës plenare, i mbledhjeve të komisioneve dhe organeve tjera politike të Këshillit Nacional janë të disponueshme në faqen e internetit të Këshillit Nacional. Këto nuk janë të përqendruara në një vend por janë të ndara sipas organit të caktuar.

Figura 7. Agjenda njëvjeçare e punës e Këshillit Nacional Sllovak (e disponueshme vetëm në gjuhën sllovake)<sup>18</sup>



### Përbajtja e kalendarit

Kalendari përban informata për një javë të seancave plenare, mbledhjet e komisioneve, mbledhjet e komisioneve kryesore dhe afatet për dërgimin e propozim-projekteve për shqyrtim në seancën plenare dhe lexim të parë. Informacionet plotësuese janë të disponueshme në agjendën e veçantë javore për seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve.

18 HARMONOGRAM schôdzi Národnej rady Slovenskej republiky rok 2021. Dostupné z: <https://www.nrsr.sk/web/Dynamic/DocumentPreview.aspx?DocID=486850>.

Në kalendar janë mbuluar në mënyrë specifike këto aspekte:


- Mbledhjet e Trupave të punës (komitetet, komisionet) janë përfshirë në kalendar.
- Agjenda e punës e Kryetarit nuk është përfshirë në kalendar por është e disponueshme në pjesën e faqes të internetit të Kryetarit.<sup>19</sup>
- Nuk janë përfshirë vizitat ose takimet ndërkombëtare, por agjenda e Kryetarit dhe nënkryetarëve është në dispozicion në pjesët e veçanta.
- Nuk janë përfshirë takimet e grupeve të deputetëve.
- Ngjarjet e hapura për publikun (seminaret, vizitat, ngjarjet kulturore) nuk janë në kalendar, por në internet në pjesën e veçantë.<sup>20</sup>

---

19 Kalendar podujatí predsedu NR SR. Dostupné z: <https://www.nrsr.sk/web/?sid=predseda/informacie/podujatia>.

20 Verejnosť a médiá Kontakt. Dostupné z: <https://www.nrsr.sk/web/default.aspx?SectionId=152>.

# SUEDIA



Parlamenti i Suedisë është njëdhomësh dhe quhet Riksdag. Zgjedhjet e përgjithshme mbahen çdo katër vjet në muajin shtator. Parlamenti, përkatësisht Riksdag mbledhet në afat prej katër ditësh pas shpalles së rezultateve zyrtare dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë. Riksdag mbledhet në shtator në ditën e përcaktuar nga legjislatura e mëparshme. Në fillim të seancës, Kryeministri jep një ekspozitë për politikën e Qeverisë (d.m.th. plan të aktiviteteve Qeveritare prej ku buron vëllimi i punës për iniciativat ligjvënëse). Seanca zgjat deri në fillim të seancës tjetër.

Ligji për Parlamentin e Suedisë *Riksdag* (2014:801) nuk përmban dispozitë specifike që rregullon procesin e përcaktimit të programit të punës. Për legjislaturën vijuese, *Riksdag* publikoi një program për të gjithë periudhën e shtatorit të vitit 2018 menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme.<sup>21</sup> Në shtator të vitit 2020 u publikua një version i përditësuar i planit të seancave parlamentare për periudhën e viteve 2020-2022.<sup>22</sup>

Këshilli i Riksdag-ut udhëheq me organizimin dhe planifikimin e punës të administratës së Riksdag-ut. Këshilli përbëhet nga Kryetari dhe dhjetë deputetët e Riksdag-ut të emëruar nga grupet e deputetëve sipas parimit të përfaqësimit proporcional. Falë përfaqësimit proporcional, Këshilli ka legjitimitet që të rregullojë punën e Riksdag-ut.

Ligji i Riksdag-ut gjithashtu përcakton mundësinë e propozimit të pikave për punën e Riksdag-ut dhe kush mund të vendos pika për diskutim. Në Ligjin për Riksdag-un, në Kapitullin 9, i jepet mundësi Qeverisë në formë të propozim-ligjeve apo komunikimit me shkrim, çdo deputeti të Riksdag-ut në formë të propozimit individual; komisioneve në formë të paraqitjes së iniciativës së komisionit; dhe në organet e caktuara të Riksdag-ut në formë të dërgimit të një raporti. Ligji për Riksdag-un gjithashtu përcakton edhe kufizimet kohore për dorëzimin e propozimeve të pikave të rendit të ditës përpara se të mbahet diskutimi për to. Kufizimi më rigoroz është paraparë për Ligjin për politikën fiskale, të cilin Qeveria duhet ta prezantojë jo më vonë se më 15 prill dhe Ligjin për buxhet jo më vonë se në 20 shtator. Përveç kësaj, Ligji gjithashtu përcakton kufizimet kohore për diskutimet para zgjedhjeve të përgjithshme.

Procesi legjislativ fillon me dorëzimin e një pike, e cila duhet të shqyrtohet në Parlament. Kjo, më pas i dërgohet automatikisht komisionit amë sipas fushës së caktuar. Komisioni pastaj duhet të hartojë një raport për të cilin merret vendim në seancë plenare. Pas diskutimit në komision, pika e njëjtë dërgohet për diskutim dhe marrje të vendimit në seancë plenare.

Kapitulli 11 i Ligjit për Riksdag përcakton se si të rregullohet puna e Parlamentit. Një pikë mund të diskutohet vetëm nëse Raporti i komisionit është i disponueshëm për deputetët të paktën dy ditë para se të shqyrtohet nga seanca plenare. Ligji për Riksdag-un nuk përmban dispozita të tjera që rregullojnë përcaktimin e rendit të ditës të punës së Parlamentit. Megjithatë, Kryetari i Riksdag-ut ka kompetenca që ta caktojë rendin e ditës të seancës së Parlamentit dhe të radhisë pikat për diskutim në ditë të ndryshme të punës. Nëse ka një rrethanë të jashtëzakonshme që mund të kërkojë për shembull shkurtime të kohës ndërmjet publikimit të raportit të komisionit dhe diskutimit në seancë plenare, Kryetari duhet të konsultojë kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin e komisionit.

---

21 *Preliminär sammanträdesplan för kammaren*. Dostupné z: <https://www.riksdagen.se/globalassets/02.-kalender/langtidsplan-2018-2022.pdf>.

22 *Preliminär sammanträdesplan för kammaren*. Dostupné z: <https://www.riksdagen.se/globalassets/02.-kalender/preliminar-sammantradesplan-2020-2022.pdf>.

Sipas neneve 15–17 agjenda dhe rendi i ditës për punën e Parlamentit diskutohen për periudhën zgjedhore për të cilën të njëjtat ishin propozuar. Riksdag-u mund të vendosë shtyrjen e pikës në seancën e parë parlamentare të periudhës së ardhshme.

Në një ueb-faqe të veçantë publikohet kalendari javor dhe mujor i aktiviteteve të Riksdag-ut. Megjithatë, nuk ka dispozitë në Rregullore që do të rregullonte funksionimin e tij. Kalendari përfshin të gjitha pikat e rendit të ditës (agjenda e debateve dhe vendimeve, debati i liderëve partiakë, mbledhjet e komisioneve dhe ngjarje të tjera).

## **NË Ç'MËNYRË JANË TË RREGULLUARA DISKUTIMET PARLAMENTARE?**

Sipas Ligjit për Riksdag-un, diskutimi i deputetëve kufizohet në katër minuta.

### **Votimi**

Në ligjin për Riksdag-un nuk ekziston ndonjë dispozitë që do të përcaktojë kohën e saktë të votimit. Megjithatë, në kalendar jepet një kornizë kohore për votim kur Riksdag-u voton për pika të caktuara. Në këto korniza kohore nuk janë të përfshira të gjitha rendet e ditës për të cilat është përfunduar diskutimi.

## **STRUKTURA DHE DISPONUESHMËRIA E KALENDARIT**

### **Si është rregulluar kalendari në aspekt juridik?**

Nuk ka dispozitë ligjore për kalendarin e parlamentit me qëllim të informimit të qytetarëve.

### **Si është struktura e kalendarit dhe kush e propozon atë?**

Kalendari përmban informata për punët e seancave plenare dhe mbledhjet e komisioneve, si dhe për ngjarje të tjera të Riksdag-ut. Këshilli i Riksdag-ut është formalisht përgjegjës për përpilimin dhe shpërndarjen e kalendarit/rendit të ditës (shih më sipër).

### **Kush e miraton kalendarin?**

Kalendari e pasqyron punën e Riksdag-ut. Duke pasur parasysh sistemin e punimeve vjetore të Parlamentit, periudha e punës e Riksdag-ut është përcaktuar në Rregullore. Agjenda e ditëve të punës përcaktohet shumë më përpara nga Këshilli i Riksdag-ut. Përcaktimi i rendit të ditës përkatëse të punës është përgjegjësi e Kryetarit, i cili vendos pikat për diskutim.

### Cila periudhë është mbuluar me kalendar?

Programi i ciklit parlamentar është në dispozicion për një periudhë dy vjeçare. Kalendarin në faqen e internetit të Riksdag-ut mbulon të gjitha ngjarjet e ardhshme të cilat janë konvokuar.

### Në ç' mënyrë kalendarin është i disponueshëm për qytetarët?

Kalendarin është i disponueshëm për qytetarët në faqen e internetit të Riksdag-ut.<sup>23</sup> Kalendarin mundëson filtrimin e përmbajtjes të shfaqur sipas aspekteve të ndryshme (seanca plenare, mbledhja e komisionit, etj.).

Figure 8. The calendar (monthly displayed) in Swedish Riksdag (available in Swedish only)

The screenshot shows the Swedish Riksdag website's calendar page. At the top, there is a search bar and navigation links for 'Lysna', 'Lästlist', 'Teckenspråk', 'In English', 'Other languages', and 'Ordbok'. The main navigation menu includes 'Start', 'Ledamöter & partier', 'Utskotten & EU-nämnden', 'Debatter & beslut', 'Dokument & lagar', 'Så funkar riksdagen', and 'Webb-tv'. The page title is 'Kalender' and it is set to 'Månad' (Monthly) view for 'Vecka 44' (Week 44). The calendar shows events for Monday 1st, Tuesday 2nd, Wednesday 3rd, and Thursday 4th of November. On Thursday 4th, there is a '10.00 Bordläggningsplenium' (10:00 Board meeting plenary) which is available on 'Webb-tv'. On the right side, there are filters for 'Typ av händelse' (Type of event) and 'Avdelning' (Committee). The 'Typ av händelse' filter includes: Beslut (5), Frågesund (1), Bordläggning (2), Debatt om förslag (6), Interpellationsdebatt (5), Kallelse och föredragningslista (2), Presskonferens (1), Resa (1), and Session (4). The 'Avdelning' filter includes: Stansida (111), Kamraren (20), Utskotten & EU-nämnden (87), Arbetsmarknadsutskottet (3), and Civilutskottet (5).

### Përmbajtja e kalendarit

- Mbledhjet e trupave të punës (komitete, komisione) janë të përfshira në kalendar.
- Agjenda e punës e Kryetarit nuk është përfshirë.
- Vizitat ose takimet ndërkombëtare janë përfshirë.
- Takimet e grupeve të deputetëve nuk janë përfshirë.
- Në kalendar jepen edhe ngjarje të hapura për publikun (seminare, vizita, ngjarje kulturore).





**REKOMANDIMET**

## V. REKOMANDIMET

Në bazë të analizave të mësipërme të sistemeve të ndryshme parlamentare dhe mënyrave se si rregullohen punimet e parlamentit, këto rekomandime mund të jenë relevante për të vendosur rregullat për punën e Parlamentit dhe caktimin e agjendës së punës në rastin e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- **Vendosja e planifikimit afatgjatë (të paktën gjysmëvjeçar) të aktiviteteve të Kuvendit dhe trupave të punës, ndërsa rekomandohet që e tërë kjo të bazohet në ciklin e rregullt të javëve të përcaktuara për aktivitete të ndryshme..**

### *Arsyetim:*

Cikli i rregullt prej katër, pesë ose gjashtë javësh mundëson planifikimin e aktiviteteve të Kuvendit dhe të trupave të tjerë të Kuvendit. Me këtë model të planifikimit, një javë e caktuar rezervohet për aktivitetet e një trupi të caktuar. Planifikimi afatgjatë i aktiviteteve mundëson që të përcaktohen ditët e seancave plenare dhe ditët për mbledhjet e trupave të punës të Kuvendit. Ditë të caktuara të javës mund të rezervohen për zhvillimin e aktiviteteve të rregullta konkrete. Për shembull, çdo e premte, për kontakte me qytetarët në njësitë zgjedhore, të hënat për takimet e grupeve të deputetëve, etj.

Ky model përdoret në të gjitha parlamentet që u përfshinë në këtë hulumtim.

- **Vendosja e datave (afateve) të detyrueshme për dorëzimin e propozim-ligjeve që do të shqyrtohen në seancën e ardhshme plenare.**

### *Arsyetim:*

Këshilli Nacional i Republikës Sllovaqe në planin e tij afatgjatë të aktiviteteve i përcakton afatet për dorëzimin e propozim-ligjeve që do të diskutohen në seancën e ardhshme plenare. Kjo është e rëndësishme për planifikimin e agjendës plenare, sidomos për t'u njohur me propozim-ligjet në lexim të parë. Vendosja e kësaj vegle rekomandohet me qëllim që të ulet numri i papritur i propozimeve të paraqitura për shqyrtim në Kuvend.

- **Të shqyrtohet heqja e diskutimit të propozim-ligjit të dorëzuar në komisione para diskutimit në seancë plenare në lexim të parë.**

### *Arsyetim:*

Shqyrtimi i propozim-ligjeve në komisione para shqyrtimit në plenare nuk është një proces i zakonshëm legjislativ. Heqja e kësaj faze mund ta lehtësojë punën e komisioneve. Shqyrtimi i propozimit, para leximit të parë, duhet të bëhet nga grupet e deputetëve.

---

# REFERENCAT

Ausschüsse. *Deutscher Bundestag* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.bundestag.de/ausschuesse>

Besuchen Sie den Deutschen Bundestag. *Deutscher Bundestag* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.bundestag.de/besucher>

ESTONIA. Riigikogu Rules of Procedure and Internal Rules Act. In: 24. částka 148. Dostupné také z: <https://www.riigiteataja.ee/en/eli/512032015002/consolide/current>

HARMONOGRAM schôdzí Národnej rady Slovenskej republiky rok 2021. In: *Nrsr.sk* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.nrsr.sk/web/Dynamic/DocumentPreview.aspx?DocID=486850>

Kalendár podujatí predsedu NR SR. *Nrsr.sk* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.nrsr.sk/web/?sid=predseda/informacie/podujatia>

Kalender. *Riigikogu* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.riigikogu.ee/tegevus/kalender-ja-eelinfo/>

Kalender. *Riksdagen* [online] [cit. 2021-11-04]. Available at: <https://www.riksdagen.se/sv/kalender/>.

Mgr. Radek Vondráček, projevy, tiskové zprávy, program. *Psp.cz* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.psp.cz/sqw/detail.sqw?id=6165>

*Preliminär sammanträdesplan för kammaren: 8 september 2020 - 28 juni 2022*. 2020, 12 s. Dostupné také z: <https://www.riksdagen.se/globalassets/02.-kalender/preliminar-sammantradesplan-2020-2022.pdf>

*Preliminär sammanträdesplan för kammaren: Valperioden 2018-2022*. 2018. Dostupné také z: <https://www.riksdagen.se/globalassets/02.-kalender/langtidsplan-2018-2022.pdf>

*RIIGIKOGU XIII KOOSSEIS: Statistikat ja ülevaateid*. Riigikogu Kantselei 2019, Eesti Rahvusraamatukogu 2019. ISBN 1736-6135. ISSN 1736-6135. Dostupné také z: <https://www.riigikogu.ee/wpcms/wp-content/uploads/2014/11/XIII-Riigikogu-statistikakogumik.pdf>

Tagesordnund und Sitzungsverlauf. *Deutscher Bundestag* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.bundestag.de/tagesordnung>

Verejnost' a médiá Kontakt. *Nrsr.sk* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.nrsr.sk/web/default.aspx?SectionId=152>

Veřejnost a média. *Psp.cz* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.psp.cz/sqw/hp.sqw?k=184>

WILLIAMSON, Andy, Andy RICHARDSON a Avinash BIKHA. *World e-Parliament Report 2018*. Geneva: Inter-Parliamentary Union, 2018, 74 s. ISBN 978-92-9142-735-2. Dostupné také z: <https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2018-11/world-e-parliament-report-2018>

XIV Riigikogu töögraafik. In: *Riigikogu* [online]. [cit. 2021-07-16]. Dostupné z: <https://www.riigikogu.ee/wpcms/wp-content/uploads/2015/02/RK2021.pdf>

# INFORMACIONE RRETH PROJEKTIT

Programi Zviceran për Mbështetje Parlamentare (PSP) do të mbështesë përpjekjet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për pavarësi përmes ndërtimit të konsensusit, reforma strukturore dhe ndërtimin e kapaciteteve në zhvillimin institucional të Kuvendit; në rolet e tij ligjvënëse dhe mbikëqyrëse; dhe në transparencën dhe llogaridhënien e tij institucional. PSP-ja, zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik, Instituti për Demokraci «Societas Civilis» - Shkup dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime, për mbështetjen e planifikimit strategjik të Kuvendit; për reforma në menaxhimin me burimet njerëzore; për vlerësimin e përmirësuar të ndikimit të rregullativës dhe proceset e prokurimit; për përkushtim ndaj të dhënave të hapura dhe përmes matjes së opinionin publik dhe monitorimit të përpjekjeve për reformë, përfshirë edhe për angazhimin më të madh qytetar në proceset e krijimit të politikave.

